



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**  
**ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT**  
**TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE**  
**PROCUREMENT REVIEW BODY**

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) Rruga “MIGJENI” (ish-Banka e Lubjanës) Kati V-të, Prishtinë, Kosovë  
Tel:+ 383 38 212 309 e-mail: [oshp@rks-gov.net](mailto:oshp@rks-gov.net)

**P.SH. Nr. 224/23**

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e OSHP-së, në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (Ligji nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe Ligjin 05/L-092) në përbërjen nga Vjosa Gradinaj – Kryetare, Agon Ramadani - Anëtare, Vedat Poterqoi - Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së Operatorit Ekonomik OE “Aroma Plus” SH.P.K. kundër Vendimit për dhënie të kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Pastrimi i objekteve për shkollat fillore në Komunë të Prishtinës” me numër të prokurimit 616-23-1001-2-1-1, iniciuar nga Komuna e Prishtinës në cilësinë e autoritetit kontraktues (AK), më 09.06.2023, mori:

**VENDIM**

1. Aprovohet si pjesërisht e bazuar ankesa e OE “Aroma Plus” SH.P.K. e datës 20/04/2023 (Protokollu Nr. 2023/0224), kurse mbetet në fuqi Vendimi i AK për dhënie të kontratës i komunikuar me njoftimin e datës 07.04.2023, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Pastrimi i objekteve për shkollat fillore në Komunë të Prishtinës” me numër të prokurimit 616-23-1001-2-1-1. Kurse vendimi i AK i datës 07.04.2023 vërtetohet.
2. Lejohet kthimi i mjetet e depozituara në emrin e tarifës ankimore, kurse ankuesi ka të drejtë të ushtroj kërkesë për kthimin e mjeteve në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi, në të kundërtën mjetet konfiskohen dhe kalojnë në Buxhetin e Kosovës në përputhje me nenin 118 të LPP lidhur me nenin 31 pika 5, të Rregullores së Punës së OSHP.

**Arsyetim**

*- Faktet dhe rrethanat procedurale –*

Me 16.02.2023, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në cilësinë e AK ka publikuar Njoftimin për kontratë për aktivitetin e prokurimit “Pastrimi i objekteve për shkollat fillore në Komunë të Prishtinës” i evidentuar me numër të prokurimit 616-23-1001-2-1-1.

Me 21.03.2023, OE “Aroma Plus” SH.P.K. ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim e cila është refuzuar me Vendimin e AK të datës 21.03.2023, me arsyetimin e se pretendimet ankimore të

OE ankues janë të bazuara në dosje te kaluara të tenderit dhe jo sipas dosjes së korrigjuar të datës 15.03.2023.

Me 07.04.2023, AK ka publikuar Njoftimin mbi Vendimin për dhënie të kontratës, duke e rekomanduar Grupin e Operatoreve Ekonomik (GOE) Internacional Group Base sh.p.k, N.P.SH Arianiti-A, Skyfterat-Live sh.p.k.

Me 12.04.2023, OE "Aroma Plus" SH.P.K ka paraqitur kërkesë për rishqyrtimin e vendimit të cituar si më sipër, e cila është refuzuar me vendimin e AK të datës 12.04.2023.

Me 20.04.2023, I pakënaqur me vendimin e AK, të datës 07.04.2023, OE "Aroma Plus" sh.p.k" ka parashtruar ankesë në OSHP, e cila është evidentuar me numër të protokollit 2023/0224.

*Elementet qenësore të këtij aktiviteti të prokurimit konsistojnë si në vijim:* Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës shërbime, kriteri për dhënie të kontratës është tenderi ekonomikisht më i favorshëm dhe vlera e parashikuar e kontratës 777,243.26 euro.

*Me rastin e shqyrtimit paraprak,*

OSHP konsideron se Ankesa e OE është ushtruar në pajtim me nenin 109.1, të LPP, sipas të cilit kundër çdo vendimi të marrë nga AK çdo palë e interesuar mund të parashtrorë ankesë pranë OSHP. Meqë OE ka ushtruar po ashtu kërkesë për rishqyrtim, do të thotë se veprimet e të njëjtit i referohen po ashtu dhe nenit 108/A të Ligjit të cituar. Prandaj, OSHP konsideron se Ankesa i plotëson kushtet e parapara në kuptim të dispozitave tani më të cituara dhe e njëjta bie nën kompetencat e tij në kuptim të nenit 105, të LPP.

Bazuar në veprimet e përshkruara si më sipër, OSHP ka angazhuar ekspertin vlerësues në pajtim me nenin 111, paragrafi 5 të LPP, me detyrë që i njëjtit në kuptim të nenit 113 të Ligjit të cituar, ta bëjë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve ankimore, përkitazi me aktivitetin e prokurimit të përshkruar si më sipër. Lidhur me këtë, me 02.05.2023 ekspertin shqyrtues ka dorëzuar Raportin e vlerësimit me rekomandimin si në vijim:

- Ankesa të refuzohet si e pa bazuar;
- Të mbetet në fuqi vendimi i AK;

Raporti i ekspertizës i cituar si më sipër është pranuar nga gjitha palët. AK është pajtuar me mendimin e ekspertit ndërsa Operatori ekonomik ankues nuk është pajtuar me mendimin e ekspertit. Paneli Shqyrtues konsideroi se lidhur me çështjen në rastin konkret, nuk ka nevojë të konvokohet seanca dëgjimore me palë, përderisa pretendimet e palëve, provat, parashtrësat e tyre dhe ekspertiza e ekspertit shqyrtues, ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritor konform nenit 24 paragrafi 1 i Rregullores së Punës së OSHP.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave –

Paneli analizoi të gjitha shkresat e kësaj lënde, përfshirë të gjitha aktet dhe/ose veprimet e palëve, konstatimet e ekspertit shqyrtues të cilat shkurtimisht prezantohen sikurse vijon:

Ankuesi pretendon se AK ka publikuar njoftimin mbi vendimin tani të atakuar me 07.03.2023, pak para përfundimit të orarit të punës. Mirëpo duke ju referuar raportit të ekspertizës lidhur me këtë pohim, vërtetohet se me këtë datë nuk është bërë Njoftimi mbi Vendimin e AK (B58), andaj ky pretendim nuk qëndron sepse AK me 07.04.2023 ka bërë Njoftimin mbi Vendimin e AK në faqen zyrtare të KRPP, sipas nenit 16.2 (I) të Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik.

Ankuesi ka pohuar se AK, nuk e ka kërkuar deklaratën e shpeshtësisë së pastrimit dhe një gjë e tillë nuk është kërkuar në Dosjen e Tenderit (DT), kurse për këtë arsye është eliminuar si administrativisht i përgjegjshëm, ndërsa te arsyetim shënohet: “*I mungon deklarata mbi Operimin (shpeshtësia e pastrimit të Sipërfaqeve sipas para masës) min.1 herë max. 3 herë*”. Sipas ankuesit, në asnjërën prej 3 dosjeve të tenderit nuk figurojnë kjo kërkesë (deklaratë). Mirëpo sipas ekspertizës dhe po ashtu nga pikëpamja e pavarur e këtij Paneli, pohimi i ankuesit në rastin konkret nuk mund të konsiderohet si pohim i një fakti, përderisa kjo nuk ishte kërkuar në DT (pavarësisht se ankuesi ka dhënë një deklaram të tillë). Ankuesi pohon se shprehimisht “*deklarata mbi Operimin*” nuk kishte kërkuar në DT, kurse sipas pohimeve të AK ajo nënkupton si e tillë sipas dosjes dhe natyrës së aktivitetit, duhet siguruar me deklaratë nga OE pjesëmarrësit, se një pastrim i tilli objekteve do të bëhet sipas kërkesës së AK, Paneli i jep të drejtë ankuesit duke e kualifikuar pohimin e tij si pjesërisht të bazuar.

Ankuesi ka atakuar vendimin e cituar si më sipër të AK po ashtu dhe nga aspekti i përmbajtjes së deklaratës së OE të rekomanduar i cili (sipas ankuesit) ka deklaruar se një shkollë do të pastrohet 6 (gjashtë) herë në ditë, vetëm për të marrë poenë më shumë. Mirëpo Paneli konsideron se një pretendim i tillë nuk mund të konsiderohet si i bazuar, sepse në shkresat e lëndës vërehet se GOE i rekomanduar ka deklaruar shprehimisht se aktivitetet e pastrimit do të zbatohen 3 herë paradite dhe 3 herë pasdite, kurse furnizimet me material do bëhen në varësi të nevojave që shfaqen.

Ankuesi ka pohuar ka ofertuar me çmim ekonomikisht më të favorshëm në raport me GOE të rekomanduar, mirëpo nga shkresat e kësaj lënde konstatohet pa ndonjë dilemë se, pikërisht nga aspekti i çmimit apo vlerës së ofertës, OE ankues është i renditur i katërti me radhë, ndërsa OE i rekomanduar është me çmim më të ulët se OE ankues për shumën 62,627.12 €. Paneli konsideron se nga ky aspekt pretendimi i ankuesit nuk është i bazuar së paku për faktin jo kontestues se oferta e OE të rekomanduar është konfirmuar si ofertë me ekonomik dhe së dyti për faktin se ky fakt, sipas DT lidhur me nenin 27 të Rregullores për Prokurim Publik, përbën apriori njërin nga kriteret me ndikim qenësor në procesin e seleksionimit dhe dhënies së një kontrate, pavarësisht se për cilin OE bëhet fjalë.

Ankuesi ka atakuar vendimin e cituar si sipër të AK dhe me pohimin se nuk është kërkuar ndonjë analizë financiare. Mirëpo sipas shkresave të lëndës dhe duke i pasur parasysh po ashtu dhe analizat paraprake sipas raportit të ekspertizës dhe njoftimit për përmisime të gabimit B54 të datës 24.03.2023 publikuar në e-prokurim nga AK konstatohet se nuk qëndron ky pohim ankimor, sepse në të vërtetë nuk është kërkuar analizë financiare por vetëm të dëshmohet me deklarate origjinale e nënshkruar dhe e vulosur nga OE dhe oferta është dorëzuar nga OE i rekomanduar është në harmoni me kërkesat e DT.

OE ankues pretendon se OE i rekomanduar për kontratë nuk e ka vendosur çmimin për njësi në pozicionin: rekapitullimi. Në këtë rast, Paneli Shqyrtues duke ju referuar analizave apo shpjegimeve të cilat lidhur me këtë pohim janë përshkruar mjaft qartë në raportin e ekspertizës, vërehet se ankuesi nuk ka të drejtë sepse, sipas dokumentit të OE së rekomanduar është llogaritur dhe/ose prezantuar para-masa për periudhën nga 1 prill 2023 deri më 30 qershor 2024 (pjesa III, para-masa e shpenzimeve higjienike) dhe qartë vërehet konstatohet çmimi për njësi me TVSH është për secilin artikull. Dhe për shkak se artikujt janë të ndryshëm, rekapitullimi nënkupton përmbledhje apo numërim i serishëm dhe nuk përmban në gabime për arsye se është dhënë çmimi njësi për një muaj dhe për 15 muaj dhe njëherësh e gjitha është e kalkuluar. Paneli në këtë rast pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues, i cili ka shpjeguar se sipas pikës 40.10 të Rregullores për Prokurimin Publik, në rast se ka mospërputhje ndërmjet çmimit njësi dhe çmimit total, çmimi i njësisë mbizotëron kurse çmimi total korrigohet. Nga ky aspekt, Paneli konsideron se raporti i ekspertizës përmban shpjegime të pranuar për këtë Panel dhe se AK ka vepruar në përputhje me nenin 72 dhe nenin 59 të LPP.

Krahas pohimeve ankimore si më sipër, Ankuesi e ka atakuar vendimin e cituar të AK dhe për faktin se, OE i rekomanduar (dhe tjerë) ka ose kanë gabuar në llogaritjen e numrit të punëtorëve duke i prezantuar gjithsejtë 118 e jo 121, sikurse është kërkuar me DT. Lidhur me këtë në pikën 2, të DT, vërehet se është përshkruar dhe radhitur numri i punëtorëve në mënyrë specifike për secilin pozicion duke i precizuar gjithsejtë në 118, përfshirë në vijim po ashtu edhe detyrimet e OE për paga të njëjta për punëtorët dhe pagesat e detyrimeve tjera sikurse kërkohen me legjislacionin e punës. Lidhur me këtë, Paneli konsideron se përgjigja dhe shpjegimet e AK (duke vendosur lidhur me kërkesën për rishqyrtim) janë të qarta, të mjaftueshme dhe nuk ka nevojë që sërish të përshkruhen dhe/pse përsëriten në këtë rast. Në kontekstin e këtyre rrethanave Paneli vëren se AK ka vepruar në pajtim me nenin 53 dhe ka siguruar informata shtesë mbi bazën e të cilave ka venë në zbatim dhe dispozitën e nenit 64, meqë informacionet shtesë i plotësojnë kriteret e kërkuara nga Autoriteti Kontraktues sipas nenit 68-71 të LPP prandaj si rrjedhojë e këtyre veprimeve Paneli konsideron se AK ka arritur që ta vërtetojë gjendjen ekonomike dhe financiare, sikurse kërkohet kjo me nenin 68 dhe aftësitë teknike dhe/ose profesione sikurse me nenin 96, të LPP.

Krahas pohimeve ankimore të analizuara si më sipër, në raportin e ekspertizës janë venë në pah po ashtu edhe veprimet dhe/ose kërkesat e AK, i cili ka kërkuar (në letrën standarde të kërkesës për sqarimin e tenderit, të datës 31.03.2023) nga GOE të rekomanduar që të dorëzojë ISO Standardet dhe të sqarojë çmimet e vendosura për të gjitha pozicionet dhe të dorëzojë një

deklaratë me shkrim të nënshkruar dhe të vulosur me të cilën GOE pajtohet të bëj sigurimin e ekzekutimit në vlerë prej 30% të vlerës së kontratës. Në këtë rast, duke ju përgjigjur kërkesave të AK, GOE të rekomanduar i ka prezantuar (në sqarimet plotësuese të datës 01.04.2023): a) të gjitha informacionet shtesë lidhur me certifikatat ISO, përfshirë dhe burimin (linkun) për verifikimin e tyre; b) shpjegimet lidhur me pozicionet dhe çmimet; c) konfirmon përgjegjësinë e plotë në përmbushjen e detyrimeve eventuale kontraktuese; d) deklarohen se pajtohen dhe me përgjegjësi të plotë e bëjnë sigurimin e ekzekutimit në vlerë prej 30% të vlerës së kontratës në pajtim me kërkesat e LPP. Paneli pajtohet në këtë rast me shpjegimet e dhëna në raportin e ekspertizës se veprimet e ndërmarra si më sipër të AK janë në harmoni me nenin 63.2.1 të LPP sipas të cilit parashihet se, Autoriteti kontraktues do të sigurojë që shumica e çfarëdo sigurie të ekzekutimit që kërkohet nga paragrafi 1. i këtij neni: (i) të jetë e barabartë me së paku dhjetë përqind (10%) të vlerës së kontratës. Në para-masën e dorëzuar nga OE ankues, gjithashtu është i njëjti format, veçse aty është plotësuar edhe kjo kolonë e cila gjithashtu paraqet shumën e njëjtë si të *totali për një muaj* (në para-masë), si të *çmimi njësi me TVSH për një muaj*, që në këtë rast pra nënkuptohet që shumatat duhet të përputhen, siç edhe është rasti me OE e rekomanduar.

Ankuesi ka pohuar se GOE të rekomanduar nuk kanë dorëzuar dokumente të cilat i ka kërkuar AK në DT sipas pikës 11.1 Krijimi i një grupi të operatorëve ekonomik. Mirëpo duke i analizuar shkresat e kësaj lënde, krahas shpjegimeve të dhëna në raportin e ekspertizës, konstatohet se pohimi ankimor nuk është i bazuar, në shkresat e lëndës figuron Marrëveshja e Konzorciumit e lidhur mes subjekteve afarist “Internacional Group” “Arianiti-A” dhe “Skyfiterat” më 28.03.2023. Kjo marrëveshje përmban të gjitha tiparet e një akti kontraktues sipas pikës 11.1 të DT, me efekt juridik mes palëve, sipas së cilës konstatohet se OE “Internacional Group” është pajisur me autorizime të plota në cilësinë e drejtuesit (lider) të grupit, i cili do të veprojë në emër dhe për llogari të këtij GOE.

- Përfundim -


Paneli shqyrtues administroi me kujdes të gjitha shkresat e kësaj lënde, të gjitha pretendimet ankimore, analizat dhe hulumtimet e ekspertit shqyrtues dhe konsideron se ankesa duhet aprovuar si pjesërisht e bazuar kurse të mbetet në fuqi Vendimin i atakuar i datës 07.04.2023, sepse AK ka vepruar në harmoni me parimet dhe dispozitat bazë të LPP përkitazi me iniciimin dhe zbatimin e këtij aktivitetit të prokurimit dhe ka shpërblyer me kontratë operatorin e ekonomik i cili ka ofruar ofertën e cila vërehet se vërtetë është në përputhje me DT duke përfshirë kërkesat teknike dhe kontraktuese, kurse lëshimet teknike të pohuara nga ankuesi duke i bazuar edhe në raportin e ekspertit nuk kishin efekt të ndryshimeve materiale në ofertë duke vepruar edhe në kuptim të nenit 6 të LPP. Paneli vuri si gjithnjë në zbatim edhe nenin 103 të LPP-së

sipas të cilit të gjitha palët e interesuara do të kenë qasje të barabartë në procedurat për shqyrtimin e prokurimit dhe në mjetet juridike dhe se asnjë vendim i OSHP, nuk do të merret në mënyrën me të cilën diskriminohet në të mirë ose në dëm të një subjekti në procedurë.

Mirëpo, duke i analizuar me vëmendje të gjitha pohimet ankimore, Paneli pajtohet me ankuesin përkitazi me lëshimet e identifikuar “deklarata e shpeshëtisë së mirëmbajtjes” dhe lëshimeve teknike të evidentuara nga eksperti . Dhe, pavarësisht faktit se ato nuk konsistojnë në ndryshime materiale të DT dhe nga ky kontekst Paneli i jep të drejtë ankuesit duke e kualifikuar ankesën e tij si pjesërisht të bazuar me të drejtë që ti lejohet kthimi i mjeteve të deponuara në emrin e tarifës ankimore megjithatë i njëjti në këtë aktivitet të prokurimit ka marr pjesë me çmim më të lartë se i rekomanduari dhe nuk ndryshon epilogu i vendimit të AK.

Duke vepruar në pajtim me kompetencat e cituara si më sipër dhe nenin 104 paragrafi 4 lidhur me paragrafi 1, sipas të cilit procedura e shqyrtimit të prokurimit do të zbatohet dhe realizohet në mënyrë të shpejtë, të drejtë dhe pa diskriminim, që ka për qëllim zgjidhjen e ligjshme dhe efektive të lëndës, nenin 1, 6 dhe duke ju referuar nenit 117 të LPP-së, dhe në provat e prezantuara si më lart, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Kryetarja e Panelit Shqyrtues  
Vjosa Gradinaj Mexhuani



**Këshillë juridike:**

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur ka të drejtë që ti drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, Dhoma e shkallës së parë - Departamentit për çështje Administrative, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Vendimi i dorëzohet:

- AK (Kuvendi i Komunës së Prishtinës)
- Ankuesit “AROMA” SH.P.K
- Arhivës së OSHP;
- Për publikim në ueb-faqe;